



---

# ***PLANI STRATEGJIK***

## ***2018-2020***

*Mbështetur nga:*





---

*ACT for SOCIETY Center*

Adresa: Rruga "Blv. Zhanë D'ark", Ndertesa 61, Hyrja 5, Apartamenti 24

Mobile: + 355 (0) 44507447

Web: [www.actforsocietycenter.org](http://www.actforsocietycenter.org)

Facebook: [www.facebook.com/pages/Center-ACT-for-SOCIETY/51195528555819?ref=hl](https://www.facebook.com/pages/Center-ACT-for-SOCIETY/51195528555819?ref=hl)

E-mail: [actfsociety@gmail.com](mailto:actfsociety@gmail.com)

TWITER: @SocietyACT

Tirana, ALBANIA



## HYRJE

Plani Strategjik 2018-2020 është pasqyrim i synimit të Qendrës “ACT for SOCIETY” për të kontribuar në *rritjen e jetesës së shëndetshme, stimulimin e zhvillimin të qëndrueshëm, promovimin e kulturës, advokimin për demokraci dhe çështjet e të drejtave të njeriut.*

Nëpërmjet këtij dokumenti strategjik, Qendra “ACT for SOCIETY”garanton realizimin e sukseshëm të këtij synimi duke ofruar një model organizate me kapacitete intelektuale, programe dhe ide të qarta për të ardhmen.

*“Ne besojmë në një shoqëri ku diversiteti, mundësitë e barabarta dhe drejtësia sociale garantojnë për të gjithë një jetesë me dinjitet”* do të jetë vizioni i qendrës për të ardhmen. Ky vizion do të shërbejë si moto për të qartësuar atë çfarë do të arrihet në tre vitet e ardhshme si dhe përparësitë e strategjitë për ndryshimet e pritshme.

Plani strategjik do të ndihmojë Qendrën për të hartuar projekte në përfitim të komunitetit dhe gjetjen e partnerëve të mundshëm për realizimin e tyre. Gjithashtu, ai do të mundësojë një komunikim dhe koordinim më të mirë të aktiviteteve të përbashkëta me aktorë të tjerë në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare.

Plani strategjik është kurorëzimi i një pune intensive të stafit të qendrës që përfshiu takime pune, intervista, mbledhje dhe analizë të dhënash.

Qendra “ACT for SOCIETY” falenderon veçanërisht “Partners Albania” që mbështeti zhvillimin e këtij plani strategjik si dhe fasilituan procesin e planifikimit strategjik.

Armela PENGILI



---

Drejtoreshë Ekzekutive

### **PROFILI I QENDRES “ACT for SOCIETY”**

Qendra “ACT for SOCIETY” është një qendër jo-fitimprurëse, e cila operon në Tiranë që nga viti 2012. Kjo qendër është regjistruar në Gjykatën e Rrethit Tiranë me vendim nr.709, datë 05.01.2012. Qendra ka gjithsej 5 punonjës, nga të cilët 2 janë me kohë të plotë, 2 punonjës janë me kohë të pjesshme dhe 1 intern, me ekspertizë në fusha të ndryshme: sociale, politike dhe ekonomike. Të gjithë punonjësit janë aktiv në mbarëvajtjen e aktiviteteve të organizatës.

Misioni i Qendrës “ACT for SOCIETY” është *“të rrisë jetesën e shëndetshme, të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm, të promovojë kulturën, të advokojë për demokraci dhe çështje të të drejtave të njeriut, duke stimuluar pjesëmarrjen aktive në proceset politikë-bërëse dhe vendimmarrëse”.*

Nëpërmjet këtij misioni qendra kontribuon në mbrojtjen e të drejtave të grupeve të grupeve të marginalizuara, në përfshirjen sociale dhe qytetarinë aktive si pjesë e të drejtave të njeriut, duke i dhënë mundësinë për pjesëmarrje të barabartë në shoqëri.



---

## **VIZIONI, MISIONI DHE VLERAT**

### **Vizioni ynë është:**

“Ne besojmë në një shoqëri ku diversiteti, mundësitë e barabarta dhe drejtësia sociale, garantojnë për të gjithë një jetesë me dinjitet”.

### **Misioni ynë është:**

*“Të rrisë jetesën e shëndetshme, të stimulojë zhvillimin e qëndrueshëm, të promovojë kulturën, të advokojë për demokraci dhe çështje të të drejtave të njeriut, duke stimuluar pjesëmarrjen aktive në proceset politike – bërëse dhe vendimmarrëse”.*

### **Vlerat tona janë:**

Integriteti dhe transparenca.

Optimizmi në realizimin e misionit dhe vizionit të qendrës.

Përgjegjshmëria në realizimin e misionit dhe vizionit të qendrës.

Diversiteti dhe profesionalizmi i stafit.

Partneriteti me aktorët e ndryshëm lokal, kombëtar dhe ndërkombëtar.



---

## **FUSHAT PROGRAMATIKE**

### **1. Të drejtat e njeriut dhe zhvillimi social**

- Barazia Gjinore
- Lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizmit
- Përfshirja Sociale

### **2. Demokracia dhe Anti-Korrupsioni**

- Qytetaria Aktive
- Mirëqeverisja dhe transparenca

### **3. Ngritje Kapacitetesh dhe Kërkimi Shkencor**

- Ideologjia “Think-Tank”
- Shërbime Konsulente: menaxhim projekti, planifikim strategjik, menaxhim organizativ, shkrim projektesh
- Trajnim për Trajnerë (TOT)

### **4. Fuqizimi i të Rinjve**

- Programi Erasmus+ (seminare, workshope, trajnime dhe shkëmbime rinore)
- Programi European Voluntary Service (EVS)
- Internship

### **5. Ndërtimi i paqes dhe kultura**

- Programi MasterPeace Albania



### III. ANALIZA MJEDISIT TË BRENDSHËM E TË JASHTËM TË QENDRËS “ACT for SOCIETY”

<i><b>Pikat e Forta</b></i>	<i><b>Pikat e Dobëta</b></i>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ekspertizë në fushën e zhvillimit social, ngritjes së kapaciteteve (te rinjve; organizatave rinore; etj), demokracisë dhe anti-korrupsionit</li> <li>• Stafi i përkushtuar dhe i kualifikuar me ekspertiza të ndryshme profesionale</li> <li>• Zhvillim dhe ngritje kapacitetesh të vazhdueshme të stafit</li> <li>• Të punuarit në grup</li> <li>• Qendra është pjesë e shumë Rrjeteve Kombëtare: Kongresi Rinor Kombëtar; Zëri të Rinjve, dhe Ndërkombëtare ENYC-European Network Youth Centers; No Hate Speech etc;</li> <li>• Larmishmëri aktiviteteve dhe impakt i qëndrueshëm</li> <li>• Transparencë dhe llogaridhënie</li> <li>• Vullnetarizmi i lartë</li> <li>• Relevanca në adresimin e nevojave</li> <li>• Imazhi i mirë i organizatës në komunitet</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mungesë qëndrueshmërie financiare dhe diversifikim fondesh</li> <li>• Pamundësi financiare për ambiente pune më të përshtatshme – hapsirë zyre më e madhe</li> <li>•</li> </ul>
<i><b>Mundësitë</b></i>	<i><b>Pengesat</b></i>



- |  |   |
|--|---|
| <ul style="list-style-type: none"><li>• Mundësitë për ngritjen e fondeve për mbulimin e aktiviteteve të qendrës</li><li>• Mundësi të mira bashkëpunimi me institucione publike, private si dhe organizata të shoqërisë civile</li><li>• Zgjerim partneriteti në nivel rajonal dhe ndërkombëtar</li></ul> | <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbështetje e limituar nga donatorët</li></ul> |
|--|---|

## ÇËSHTJET KRITIKE DHE STRATEGJITË

1. Qendra “ACT for SOCIETY” ka një *eksperiencë 6 vjeçare*. Kjo eksperiencë do t’i shërbejë për të vazhduar punën e saj për 3 vitet e ardhshme të planit strategjik. Disa nga strategjitë që ajo do të përdorë për të shfrytëzuar eksperiencat pozitive përfshijnë:
  - Përcjellja tek të rinjtë e eksperiencës pozitive dhe ekspertizës së fituar ndër vite si dhe bashkimi dhe pasurimi i eksperiencave të tjera dhe burimeve vetjake.
  - Përgatitja e materialeve publike për përvojat e sukseshme të qendrës dhe shpërndarja e tyre (buletine, fletëpalosje, postera, video, stickers, etj.)
  - Vazhdimësia në aktivitetet e mëparshme kanë qenë të sukseshme për Qendrën. Fokusi kryesor do të jetë mundësimi i projekteve të vazhdueshme në favor të përfshirjes më të gjerë të grupeve të marxhinalizuara.
2. Qendra “ACT for SOCIETY” ka patur një vazhdimësi në zbatimin e misionit të saj falë donatorëve të saj strategjikë si - UNFPA Albania, Komisioni European, Këshilli i Europës, Raiffeisen Invest, CIJA US. Synimi i qendrës është pasja e donatorëve të





qëndrueshëm, pasi këta donatorë janë vetëm me bazë projektsh. Një nga çështjet kritike për zbatimin e planit strategjik është *mungesa e donatorëve*. Disa nga strategjitë për reduktimin e vartësisë ndaj një donatori përfshijnë:

- Identifikimin e donatorëve potencial nëpërmjet formave të ndryshme
- Promovimi i qendrës tek donatorë të mundshëm që operojnë në Shqipëri nëpërmjet organizimit të eventeve të ndryshme ku të ftuar do të ketë edhe përfaqësues të organizatave të ndryshme dhe donatorë të ndryshëm.
- Përgatitja e projekteve cilësore dhe aplikimi tek donatorë të ndryshëm.
  - ✓ Pasja e një plani sigurimi fondesh përmes “shitjes së shërbimeve”

3. *Largimi i vullnetarëve të qendrës* si rezultat i reduktimit të mbështetjes financiare ka qenë një dukuri e viteve të fundit të funksionimit të qendrës. Për mbajtjen e një numri të mjaftueshëm vullnetarësh, qendra do të ndjekë këto strategji:

- Gjetja e formave të përshtatshme për motivimin në vazhdimësi të vullnetarëve të qendrës.
- Përfshirja e vullnetarëve të qendrës në aktivitete të ndryshme të parashikuara në Planin Strategjik.

4. *Qendra synon të ofrojë shërbime të cilat janë të nevojshme për komunitetin*. Një gjë e tillë rrit garancinë e realizimit të Planit Strategjik. Por nga ana tjetër, qendra do të ndjekë këto strategji për mundësimin e tij:

Njohja e vazhdueshme e situatës përsa i përket identifikimit të nevojave të përfituesve, duke përdorur forma të ndryshme si intervistime, studime, etj.

- Trajnimi i vazhdueshëm i stafit të qendrës për të siguruar shërbimet e duhura si në llojshmëri edhe në cilësi.
- Vlerësimi i vazhdueshëm i ndikimit të shërbimeve në komunitet nëpërmjet krijimit të një baze të dhënash për projekte të ndryshme.

5. *Bashkëpunimi me aktorët lokal* duke përfshirë pushtetin vendor, gjykatën, policinë, drejtorinë arsimore dhe të shëndetit publik, Ministrinë e linjës, ka qenë një ndër pikat e forta të qendrës. Mbajtja e një bashkëpunimi efektiv midis qendrës dhe aktorëve



lokalë është një nga prioritetet e qendrës gjatë zbatimit të Planit Strategjik. Disa nga strategjitë për mundësimin e një gjëje të tillë përfshijnë:

- Hartimin e projekteve dhe aplikimi në rrjetin për fuqizimin e grupeve vulnerabël për sigurimin e fondeve për projekte të caktuara.
- Bashkëpunimin me shoqatat/qendrat, lokale dhe rajonale.
- Bashkëpunimin me organet e pushtetit lokal, rendit dhe institucionet e tjera shtetore, nënshkrimi i kontratave të bashkëpunimit, si dhe shkëmbimi i përvojave me organizatat partnere.

## QELLIMET DHE OBJEKTIVAT

### Qëllimi:

*Advokimi dhe përmirësimi i çështjeve si: rinia; të drejtat e grupeve vulnerabël; mireqëverisja; demokratizimi; etj.*

### Objektivat:

- Të promovojë të drejtat e njeriut duke garantuar monitorimin e zbatimit të tyre.
- Të mundësojë përfshirjen e grupeve të marxhinalizuara duke patur në fokus problemet me bazë gjinore, të rinjtë, komunitetin rom dhe egjiptian, si dhe integrimin e komuniteteve në zonat rurale
- Të promovojë dhe të nxisë pjesëmarrjen aktive të të rinjve në proceset vendimmarrëse
- Të mbështesi ideologjinë think-tank e të simuloje kërkimin shkencor.
- Të stimulojë demokracinë, mirëqeverisjen dhe luftën kundër korrupsionit



---

## **Fushat Programatike**

Programet kryesore të Qendrës kanë qenë advokimi, informimi dhe ndërgjegjësimi i grupeve të marxhinalizuara, si pjesë e të drejtave të njeriut të garantuara me ligj. Këto programe janë realizuar nëpërmjet zbatimit të projekteve të mbështetura nga donatorë të ndryshëm. Disa prej tyre përfshijnë:

### **1. Të drejtat e njeriut dhe zhvillimi social**

- « Nje Dite Ndryshe me te Moshuarit ne Shtepine e te Moshuarve ». Projekti kishte si qellim permiresimin e statusit social te te Moshuarve duke mbeshtetur nevojat e tyre, gjithashtu duke koordinuar faktoret shteterore ne menyre qe te rrisin vemendjen ndaj ketij target grupi.
- « Grate Rurale ne Shqiperi ». Ky ishte nje projekt kerkimi per te bere me te dukshme nevojat dhe problemet e jeteses dhe punes ne zonat rurale ne Shqiperi.
- « Suporti i Grave Kryefamiljare ». Ky projekt kishte si qellim te mbeshteste grate, kryetare te familjes me rastin e Krishtlindjeve duke iu ofruar produkte sanitare e ushqimore.



- 
- « 8 Marsi Nje Dite Ndryshe me Grate Invalide ne Njesine Bashkiake Nr.2». Projekti kishte si qellim te mbeshteste grate invalide me rastin e 8 Marsit duke iu ofruar produkte sanitare e ushqimore. Projekti kishte si qellim te terhiqte vemendjen e aktoreve te ndryshem ndaj nevojave te ketij grupi vulnerabel.
  - “Stop Dhunës ndaj Grave” – Ky projekt kishte në fokus dhunën ndaj gruas, ku personazhe të njohura të skenës dhe politikës i bënë jehonë këtij fenomeni për pakësimin e rasteve të dhunës ndaj gruas.
  - “Film – REVOLUCIONI Eufrosina's” – fokusi ishte promovimi i të drejtave të grave dhe pjesmarrja në politikë.
  - “Live Vote Mascote”- Advokim mbi votimin familjar dhe të drejtës së gruas për të votuar
  - “ Barazia Gjinore në Punonjësit e Rinj: Prespektivat, Vështirësitë dhe Mundësitë”- Projekt KA2 nga Programi Erasmus Plus për të rinjtë dhe punonjësit e rinj social.



---

## 2 Demokracia dhe Anti-Korrupsioni

- « Monitorimi i Shtypit Ditor ne Luften kunder Korrupsionit ». projekti kishte si qellim te monitoronte rastet e korrupsionit te trajtuara ne Shtypin e Dites ne Shqiperi ne menyre qe te promovojë luften ndaj korrupsionit dhe mireqeverisjen.
- “Partnership Against Corruption Together-PACT” - in consortium with ANTTARC and ALCDF the main focus is to increase the engagement of CSOs in 15 municipalities of Northern Albania in good governance issues and fight against corruption by strengthening their capacity and funding their initiatives. EU Delegation in Albania 2016-2020

## 2. Ndërtimi i paqes dhe kultura

- « Dita Nderkombetare e Paqes ». Projekti kishte si qellim te rriste vemendjen e qytetareve ndaj paqes dhe te simuloje ata te ndalojne konfliktet e cdo natyre ne shoqerite e tyre.
- « Dita kunder Diskriminimit ne Bashkine Rubik ». Projekti kishte si qellim informimin e stafit te Bashkise se Rubikut per mjete te ndryshme per te promovuar anti-racizmin te qytetaret e saj.



- “Hand in Hand for Diversity, Stop Racism”, ky aktivitet ishte në kuadër të informimit në gjimnazin Qemal Stafa në Fush-Krujë, dhe në shkollën fillore “Tufina” në Tirana mbi moskrijimin e barrierave mbi çështjet e racizmit.
- “Jo Urrejtjes/Remember 9 November”- ACT for SOCIETY Center, si pjesë e UNITED for Intercultural Action Network, prezantoi në qytetin e Fush-Krujës, fushatën Again Anti-Semitism and Fascism: No Hate/Remember 9 November, një info session në gjimnazin Shote Galica.
- “Tipologjia e dhunuesit dhe efektiviteti i matjes së rehabilitimit”- ishte një forum mbi fushatën No Hate Speech me personazhe VIP të cilët bashkëbiseduan me studentët se sa e vështirë është për një personazh VIP në një vënd të vogël si Shqipëria të eci përpara duke patur gjatë gjithë kohës paragjykime për karrierën e tyre.

### **3. Fuqizimi i të Rinjve**

- « Dita Anti-Racizmit ne Gjimnazin Ismail Qemali Tirane». Projekti kishte si qellim te inkurajonte nxenesit e shkolles se mesme « Ismail Qemali » ne Tirane te luftojne racismin dhe cdo forme tjeter diskriminimi ndermjet grupeve te ndryshme.
- “Sot është dita që ne zgjodhëm të Ndryshojmë”- ku në fokus kishte promovimin e barazisë gjinore nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme në gjimnazet e zonave Rurale të Tiranës.



- 
- “Capacity Building of Y-PEER network, rising awareness and advocacy” ku bazë e këtij projekti ishte promovimi i të drejtave të njeriut nëpër mjet 5 miniprojeteve për 5 Ditë Ndërkombëtare.
  - “No Hate Man”- Ky projekt pilot ka të bëjë me disponueshmërinë e informatave dhe edukimit cilësor për të rinjtë, vajzat dhe djemtë, si përgjigje ndaj dhunës ndaj vajzave në Tiranë, si dhe për të përfshirë të rinjtë në ndryshimin e stereotipave gjinorë.
  - “Youth and Gender”- Nëpërmjet teatrit të të shtypurve promovojmë gjininë dhe edukimin për të rinjtë dhe djemtë, si përgjigje ndaj dhunës kundër djemve dhe vajzave në Krujë dhe Fushë-Krujë.



Implementimi i këtyre projekteve ka ndikuar në përmirësimin e jetës dhe statusit të këtyre grupeve vulnerabël dhe ka bërë që të njihet qendra në komunitet. Aktualisht, qendra e ka shtrirë veprimtarinë e saj në nivel lokal dhe kombëtar. Në të ardhmen, ajo synon të forcojë kapacitetin e saj duke afruar më shumë aktivist, të zgjerojë numrin e punonjësve të saj dhe të zgjerojë veprimtarinë edhe në nivel rajonal.

Qendra ka bashkëpunim të mirë me organet e pushtetit vendor dhe qendror, organizata jo qeveritare që punojnë në Tiranë dhe në rrethe, si dhe me organizata të tjera në rajon e me gjerë, etj., gjë që është mundësuar nëpërmjet hartimit të marrëveshjeve të bashkëpunimit projekt pas projekti.

## **MENAXHIMI**

### **STAFI Qëllimi:**

*Të kemi një staf në rritje të qendrës dhe ekspertiza të ndryshme profesionale për të mundësuar përmbushjen me sukses dhe efikasitet të qëllimeve të qendrës.*

### **Objektivat:**

1. Deri në fund të vitit 2020, të rrisim stafin e qendrës.
2. Të sigurojmë një staf me ekspertizën e nevojshme për të adresuar aspekte të caktuara të mbrojtjes së të drejtave të grupeve vulnerabël (psiko-sociale, ligjore, etj.).
3. Të rrisim kapacitetet e qendrës në aspekte të ndryshme të advokimit/lobimit për të drejtat e njeriut.
4. Të rrisim motivimin e vullnetarëve dhe stafit të qendrës nëpërmjet formave të ndryshme.

### **BORDI Qëllimi:**

*Të mbajmë një bord aktiv në realizimin e vizionit dhe misionit të qendrës.*

### **Objektivat:**

1. Të rishikojmë përbërjen e bordit dhe rregulloren e funksionimit të tij.
2. Të motivojmë anëtarët e bordit nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme të qendrës.
3. Të rrisim rolin e bordit në promovimin e qendrës.





## PLANIFIKIMI

**Qëllimi:** *Të rrisim ndikimin e aktiviteteve të qendres tek përfituesit.*

### **Objektivat:**

1. Të promovojme planin strategjik tek partnerë e aktorë të ndryshëm të qendres
2. Të sigurojmë një sistem të planifikimit afat-gjatë dhe operacional të planifikimit, monitorimit, dhe vlerësimit.
3. Të sigurojmë një bazë të dhënash për përfituesit dhe ndikimin e aktiviteteve të organizatës tek ata.

## ZHVILLIMI I BURIMEVE

**Qëllimi:**  
*Të përmirësojmë situatën financiare të qendres*

### **Objektivat:**

1. Brenda periudhës 3-vjeçare, të shkruajmë e të paraqesim projekte për mbështetjen financiare të planit strategjik.
2. Të krijojmë një bazë të dhënash për donatorët potencialë vendas dhe të huaj.

## INFRASTRUKTURA

**Qëllimi:**  
*Te rrisim efikasitetin dhe efektivitetin e operimit të qendres.*

### **Objektivat:**

1. Të vëmë në funksion të qendres një zyrë të pajisur me orëditë e nevojshme për operimin normal të saj.
2. Të sigurojmë një mjedis brenda zyrës së qendres për takime dhe këshillime të përfituesve.



## MARREDHENIET PUBLIKE

### **Qëllimi:**

*Të rrisim imazhin pozitiv të qendres në nivel kombëtar dhe atë të donatorëve.*

### **Objektivat:**

1. Të promovojmë në mënyrë të vazhdueshme programet tona duke përdorur materialet e botuara dhe botimin e materialeve të tjera të marrëdhënieve me publikun.
2. Të rrisim kontaktet me mediat lokale dhe qendrore.

## RRJETI I BASHKEPUNIMIT

### **Qëllimi:**

*Të rrisim bashkëpunimin me organizatat partnere brenda dhe jashtë vendit.*

### **Objektivat:**

1. Të organizojmë dhe realizojmë aktivitete të përbashkëta me organizata të ngjashme.
2. Të rrisim pjesëmarrjen e qendres në aktivitetet e rrjeteve ku ne bejme pjese
3. Të mbajmë kontakte të vazhdueshme me organizatat e tjera jo-qeveritare.

Ky Plan Strategjik i Qendrës “ACT for SOCIETY” është produkt i punës së vazhdueshme të stafit dhe mbështetjes së donatorëve dhe botohet në kuadër të transparencës së plotë të qendrës ndaj publikut.

Të drejtat e autorësisë mbi materialin e prezantuar në këtë Plan Strategjik i përkasin qendrës “ACT for SOCIETY”.

@Qendra “ACT for SOCIETY

